



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Prrenjas më 08.09.2025

**SHPLLJE
PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
PRANIM NË SHËRBIM CIVIL
NË PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË NË KATEGORINË E LARTË
DREJTUESE**

**Lloji i diplomës “Arsimi i Lartë Shkenca Ekonomike/Juridike”
Niveli minimal i diplomes “Master Shkencor”**

Në zbatim të nenit 32 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, mënaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nivelit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, ndryshuar me VKM nr. 388, datë 06.05.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 118, datë 05/03/2014”, të Vendimit nr. 18, datë 27.02.2025 të Këshillit Bashkiak “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil të Bashkisë Prrenjas për vitin 2025”, Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 195, datë 27.05.2025 “Për nisjen e procedurave të shpalljes së vendeve vakante në Bashkinë Prrenjas për vitin 2025 në zbatim të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil” shpall procedurat e plotësimit të vendit të lirë në kategorinë e lartë drejtuese për pozicionin:

• **SEKRETAR I PËRGJITHSHËM/KATEGORIA E PAGËS I-5**

Pozicioni më sipër është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë si dhe për aplikantë të tjerë jashtë shërbimit civil të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurim.

**PËR TË DY PROCEDURAT (NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	18.09.2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	23.09.2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL	23.09.2025

PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN MË SIPËR ËSHTË:

- a) Formulon politikat e institucionit dhe merr masa për zbatimin e tyre;
- b) Koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga seksionet/drejtoritë, të cilat kanë lidhje midis tyre, gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës që mbulon institucioni;
- c) Siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat, duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve;
- d) Siguron drejtim strategjik afatgjatë;
- e) Merr masa për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të institucionit dhe përgjigjet përpara Kryetarit të Bashkisë në përputhje me legjislacionin.
- f) Identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve, për përmirësim të politikave, programeve dhe performancës institucionale;
- g) Menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të institucionit;
- h) Organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësive kryesore administrative;
- i) Siguron një klimë bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirjeje të stafit dhe promovon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore;
- j) Është përgjegjës për ristrukturimin organizativ të institucionit;
- k) Miraton përshkrimet e punës së nëpunësve të institucionit;
- l) Promovon iniciativë për përmirësimin e shërbimeve me publikun;
- m) Përfaqëson institucionin, me autorizim të titullarit, brenda dhe jashtë vendit;
- n) Kryen detyra të tjera të ngarkuara me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, etj.

I LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

-Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”ose të barazvlefshme me të në fushën e Shkencave Ekonomike/Juridike.

(Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).

-Të jetë nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura (kategoria I-5)

-Të gëzojë integritet të lartë moral dhe profesional.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.09.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22.09.2025** Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit të Bashkisë, **listën e kandidatëve** që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, vendin, datën dhe oren e sakte.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrenjas, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij ;
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar,

- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar,
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i përditësuar;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar,
- g) Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- h) Njohuri në lidhje me ligjin nr. Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 dhe Ligjin nr. 14/2023,
- i) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar
- j) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,i përditësuar
- k) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;i përditësuar,
- l) Njohuri mbi menaxhimin e riskut;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- ☐ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ☐ Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- ☐ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” .

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrrenjas do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 NGRITJE NE DETYRE OSE PRANIM NGA JASHTË

Për këtë procedure kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kandidatët nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme dhe kritere të vecanta:

Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të Ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g. të plotësojë kërkesat e posacme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posacme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

-Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose të barazvlefshme me të në fushën e Shkencave Ekonomike/Juridike.

(Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).

-Të kenë të paktën 10(dhjetë) vjet përvojë profesionale nga të cilat jo më pak se 5 vite në pozicione drejtuese të nivelit të mesëm ose të barazvlefshme me të;

-Të gëzojë integritet të lartë moral dhe profesional.

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përvec kritereve si më sipër, duhet të plotësojnë edhe kriteret minimale si vijon:

-Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në gërmat “a” deri në “dh” të nenit 21 të ligjit 152/2013.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Përrnjas dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Prrenjasit brenda datës 23.09.2025.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.10.2025** NJBNJ në Bashkinë Prrenjas do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkurimi.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e vecanta do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- m) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij ;
- n) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar,
- o) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar,
- p) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- q) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i përditësuar;
- r) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar,
- s) Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- t) Njohuri në lidhje me ligjin nr. Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 dhe Ligjin nr. 14/2023,
- u) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar
- v) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,i përditësuar

- w) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;i përditësuar,
- x) Njohuri mbi menaxhimin e riskut;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- d- Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar
- e- Aftësi komunikimi
- f- Aftësi të drejtimit strategjik
- g-Ndërtim i marrëdhënieve personale
- h- Efektiviteti, aftësi pune në grup

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi maksimal është **100 pikë** dhe përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

- a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, duke përfshire (vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore) **10 pikë**;
- b) testim me shkrim, **40 pikë**;
- c) intervistën e strukturuar me gojë, **50 pikë**

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Kandidatët do të njoftohen për datat e zhvillimit të procedurës së testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë në përfundim të procesit të vlerësimit paraprak të kandidatëve.

Lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë dhe brenda numrit të pozicioneve për të cilat konkurohet, do të shpallet në stendat e informimit public të Bashkisë Prrenjas dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga Bashkia Prrenjas nëpërmjet adresës së tyre të e-mailit.